



Kuvendi Komunal / Skupština Opštine / Muncipal Rahovec

Në bazë të nenit 12, nenit 17 pika (r) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës nr. 03/L-40, Nenit 2, nenit 5, të Statutit të Komunës së Rahovecit 01Nr 569/1 i dt. 16.12.2010 , propozimit të Kryetari i Komunës me nr.prot. 353 të dt. 27.07.2016, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 19 Gusht 2016, merr këtë :

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës me nr. të protokollit 353 të datës 27.07.2016, për shpalljen e interesit të përgjithshëm të ngastrës me nr. 236-1, për zhvillimin e aktiviteteve kulturore-artistike , sportive dhe rinore.
- II. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm të kësaj ngastre është zhvillimi i aktiviteteve kulturore-artistike , sportive dhe rinore që është PSH e Kosovës, KK. Rahovec me numër të ngastrës nr. 236-1, sipas Certifikatës me nr. 08-3952 të datës 22.07.2016, P-71510018-00236-1 në vendin e quajtur Leskovac-Zhivina/Leskovac me sipërfaqe të përgjithshme 12833 m², tokë - kullosë e klasit 3 (tretë), në zonën Katastrale Dejnë.
- III. Ngastra kadastrale e cekur në pikën II të këtij vendimi ti bartet Drejtorisë për Kulturë , Rini dhe Sport për zhvillimin e aktiviteteve kulturore -artistike , sportive dhe rinore .
- IV. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik do të jetë Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në komunën e Rahovecit.
- V. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në Web – faqen zyrtare të Komunës së Rahovecit.

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01 Nr. 2580
Rahovec, 19.08.2016



Kryesuesi i Kuvendit

Nahit Elshani



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 2580 Më Dt. 19.08.2016
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC